



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. 1856/3 prot.

Tiranë, më 02.08.2023

**NJOFTIM ME SHPALLJE**

**TË VENDIMIT NR. 1856/1, DATË 29.06.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PA NJË VENDIM PËRFUNDIMTAR TË PRAKTIKËS SË PËRCJELLË NGA ISH KLD, LIDHUR ME VERIFIKIMIN E ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASI Z. SABAH VEIZAJ, NDAJ ISH GJYQTARIT TË GJYKATËS SË APELIT VLORË, Z. H.S.”**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e z. Sabah Veizaj me nr. 1345 prot., datë 24.06.2020, nr. 1398 prot., datë 29.06.2020 ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratit z. H.S., gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe me vendimin nr. 1856/1, datë 29.06.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për përfundimin e procedurës së verifikimit pa një vendim përfundimtar të praktikës së përcjellë nga ish KLD, lidhur me verifikimin e ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Sabah Veizaj, ndaj ish gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Vlorë, z. H.S.”, bazuar në nenin 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Proedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur përfundimin e procedurës së verifikimit të ankesës. Vendim duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Vlorë, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Uji i Ftohtë, Vlorë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: [www.ild.al](http://www.ild.al).

Shpalljet që do të afishohen në ambientin e bashkisë përkatëse, do të hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

